

Shënohet Dita botërore e Planetit Tokë

23/04/2009 12:53:00

Madhësia: - +



Sa i kushtohet rëndësi ruajtjes së ambientit tek ne? Në ditën botërore të planetit tokë, nxënësit e disa shkollave të kryeqytetit me grumbullimin e shisheve plastike, kanë demonstruar në praktikë projektin "Për ambient më të pastër" të financuar nga USAIDI.

Në mënyrë demonstrative fëmijë të shkollave të ndryshme grumbullonin shishe plastike për të dëshmuar rëndësinë e ruajtjes së mjedisit ku mësojnë dhe jetojnë.

"Ne këtu u mbledhëm që ta bëjmë planetin më të pastër, që ti mbledhim të gjitha mbeturinat pasi planeti është një dhe I tillë do të mbetet; nuk kemi planet rezerv për këtë arsye duhet ta pastrojmë dhe kujdesemi për çdo ditë", thotë një nxënëse.

Sipas disa studimeve amerikane Maqedonia renditet ndër vendet e fundit për nga niveli I pastërtisë. Ministria e ekologjisë e njohur me këtë fakt bashkë me qytetin e Shkupit paralajmërojnë projekte mbajtjen e projekteve të ndryshme.

"Fatkeqësisht ne nuk jemi në nivelin e duhur të njohur me problemet e ambientit jetësor me mënyrën se si do të duhet silllemi ndaj saj ndoshta këtu fajin këtu e kanë edhe institucionet kompetente relevante por ne ndërmarrim masa aktive konkrete edhe në edukimin edhe në informimin edhe në masat për të parandaluar nëpërmjet të ligjeve të ndryshme të cilat mbrojnë ambientin jetësor", tha ministër i Ekologjisë, Nexhati Jakupi.

"Do të bëjmë një projekt me të cilin dëshirojmë që fillimisht të ngremë vetëdijen e qytetarëve se do të duhet të selektohen mbeturinat, më pas atë mbledhje selektive ta dërgojmë në Drislla ku mbeturinat do të mund të riciklohen dhe serish të mund të shfrytëzohen", thotë kryetari i qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski.

Edhe ndalesa e përdorimit të qeseve plastike tanimë 5 muaj ka dhënë efektet e saj. Sipas ministrisë së ekologjisë për 70% ka rënë prodhimitaria e tyre njashtu edhe kërkesa e konsumatorëve për ti marrë ato.

Meral Ismaili